



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 745/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afjete Sada-Gllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtar si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur lidhur me apelin e Rashit Qalaj nga Lipjani, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave me postë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.745/2021 i datës 05.03.2021, i paraqitur Rashit Qalaj nga Lipjani, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave.

A r s y e t i m

Me datë 05.03.2021, kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Rashit Qalaj ka paraqitur në PZAP, apelin Anr.745/2021 me të cilin pretendon se më datë 03.03.2021 në QNR gjatë numërimit të votave me postë të subjektit politik PDK, janë bërë keqpërdorime me këto vota duke ju bartur votat kandidatëve që e kanë pasur të sigurt mandatin tek kandidatët që i kanë pasur nga qyteti i tyre dhe ashtu i kanë vendos në sistem.

Paneli, pasi që shqyrtoj apelin vlerësoi se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtresuesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave me postë, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë të imagjinuara sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Rashit Qalaj i subjektit politik PDK, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave me postë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 745/2021 më datën 06.03.2021

Kryesuesja e Panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.